



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit të 40, pika 40.2, shkronja a e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 2, pika 2.3, nenit 8, shkronja e dhe nenit 21, pika 21.2 të Ligjit nr. 03/L – 049, për financat e pushtetit lokal, të nenit 5, shkronja f të Ligjit nr. 03/L – 068, për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja a e Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 24.06.2014, miratoi këtë

**RR E G U L L O R E**  
**PËR**  
**TË HYRAT VETANAKE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

**I. Dispozitat e përgjithshme**

**Qëllimi**

**Neni 1**

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen burimet, qeverisja dhe shpenzimi i të hyrave vetanake të institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës.

**II. Burimi, qeverisja dhe shpenzimi i të hyrave vetanake**

**Burimet e të hyrave**

**Neni 2**

2.1. Institucionet arsimore kanë këto burime të të hyrave vetanake:

- a) pagesat nga prindërit dhe komuniteti;
- b) pagesat për regjistrimin e vijuesve në arsimin për të rritur;
- c) pagesat për dhënien e dokumentacionit për përfundimin e vitit shkollor dhe përfundimin e shkollimit;
- d) pagesat për kryerjen e shërbimeve dhe nga shitja e prodhimeve;
- e) donacionet dhe dhuratat, dhe
- f) pagesat për dhënien e hapësirave dhe lokacioneve me qira.

2.2. Të gjitha të hyrat vetanake të institucioneve arsimore konsiderohen të hyra vetanake të Komunës, por që njëkohësisht janë të hyra të dedikuara për institucionet përkatëse arsimore.

2.3. Lirohen nga pagesa kategoritë e caktuara të fëmijëve të vendosur në institucionet parashkollore publike, pas dhënies së pëlqimit nga komisioni i Drejtorisë së Arsimit, si vijon:

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës dhe fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) lirohen nga pagesa 100 %;
- b) Fëmijët që kanë vetëm njërin prind lirohen 50%;
- c) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do të paguaj tarifen e plotë, për të dytin 30% më pak, ndërsa për fëmijën e tretë 50 % të tarifës.

2.4 Nga pagesa për hapësirat dhe lokacionet e dhëna me qira, në bazë të kërkesës së të apostrofuarve në vazhdim dhe dhënies së pëlqimit - Vendimit të Drejtorisë së Arsimit/Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lirohen:

- a) veteranët, invalidët, familjet e dëshmorëve të kombit,
- b) personat me nevoja të veçanta,
- c) punëtorët e administratës komunale dhe
- d) pjesërisht bëjnë pagesën për t'i mbuluar shpenzimet e mirëmbajtjes së shkollës dhe plotësisht, klubet sportive të Komunës së Prishtinës, anëtare të federatave të regjistruara në Republikën e Kosovës (Federata e Sportit bënë propozimin) si dhe organizatat kulturore - edukative, të cilat ushtrojnë aktivitetet jofitimprurëse dhe që konsiderohen me interes publik.

### **Mënyra e arkëtimit të mjeteve vetanake.**

#### **Neni 3**

3.1. Institucioni arsimor është i obliguar që grumbullimin e mjeteve vetanake ta bëjë në mënyrë transparente, duke përfillur procedurat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMFPP).

3.2. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i pagesave do të bëhet në përputhje me LMFPP - në.

### **Angazhimi i personelit të institucionit arsimor dhe i personave jashtë institucionit arsimor**

#### **Neni 4**

4.1. Personeli arsimor dhe jo arsimor i institucionit me orar të plotë të punës, për punën prodhuese dhe kryerjen e shërbimeve, mund të angazhohet në punën shtesë, sipas

dispozitave të Ligjit 03/L - 122, për punë, dhe dispozitave të Ligjit nr. 03/L - 149, për shërbimin civil të Kosovës.

4.2 Sipas nevojës, institucioni arsimor mund të angazhojë edhe fuqi tjetër punonjëse jashtë institucionit arsimor. Ky angazhim bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës.

## **Pagesat**

Pagesat nga prodhimi ose krijimtaria

### **Neni 5**

Produktet e prodhuara dhe të krijuara nga institucioni arsimor, do t'i nënshtrohen shitjes në bazë të procedurave të parapara me ligj.

Pagesat për dhënien me qira

### **Neni 6**

Tarifat për dhënien me qira të hapësirave dhe lokaleve të institucionit arsimor, do të jenë:

- a) për shfrytëzimin e tokës së institucionit arsimor, tarifa mujore së paku ..... 1 €/m<sup>2</sup>;
- b) për shfrytëzimin e lokaleve në pronësi të institucioneve arsimore, tarifa mujore së paku ..... 2 €/m<sup>2</sup>;
- c) për shfrytëzimin e sallave apo hapësirave të tjera të ngjashme.....15 € për orë (60 min).

Pagesa për regjistrim dhe lëshimin e dokumentacionit për arsimin për të rritur dhe arsimin e rregullt:

### **Neni 7**

7.1 Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) për regjistrim të vitit (për një klasë 100 €) .....100 €;
- b) për praktikë profesionale .....50 €;
- c) për provim diferencial ..... 10 €;
- d) për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën ..... 30 €;
- e) për diplomë të përfundimit të shkollimit.....20 €.

7.2 Pagesa për lëshimin e dokumentacionit për vijuesit e arsimit për të rritur dhe të rregullt:

- a) për duplikatë të dëftesës .....1 €
- b) për duplikatë të diplomës, certifikatës ..... 1 €

## **Qeverisja me të hyrat vetanake**

### **Neni 8**

Mjetet vetanake të grumbulluara nga pagesat, shpërndahen në pozicionet:

- a) shërbime dhe mallra,
- b) shpenzime kapitale,
- c) kompensim për personelin e angazhuar.

### **Neni 9**

Pas ndarjes së mjeteve për pagesë personelit të angazhuar, pjesa tjetër do të ndahet për shërbime dhe mallra dhe shpenzime kapitale, sipas nevojës.

### **Neni 10**

Institucioni arsimor mund t'i shfrytëzojë mjetet vetanake për këto qëllime:

- a) Për mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve, meremetimin e objektit dhe zgjerimin e veprimtarisë së institucionit;
- b) Për furnizim me pajisje dhe literaturë profesionale;
- c) Për aftësimin e personelit arsimor dhe të bashkëpunëtorëve;
- d) Për ekskursionet profesionale, të parapara me planprogramin mësimor, si dhe me planin vjetor të punës së institucionit arsimor;
- e) Për organizimin e garave nga vetë institucioni (në nivel vendi, rajoni apo ndërkombëtar);
- f) Për shpërblime dhënë fëmijëve, nxënësve për sukses të dalluar;
- g) Për projekte të cilat ndikojnë në ngritjen e punës arsimore - edukative dhe profesionale të institucionit arsimor dhe aftësues.

### **Neni 11**

11.1 Personelit të angazhuar në institucionet arsimore për kryerja e shërbimeve dhe të prodhimeve, pagesa për punën shtesë i bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë punën shtesë.

11.2. Punonjësit të angazhuar jashtë institucionit të arsimit, pagesa do t'i takojë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës, e që kanë të bëjnë me personin e angazhuar.

### **Neni 12**

Institucioni edukativo - arsimor - aftësues, do të mbajë dokumentacionin përkatës në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

## **Mbikëqyrja**

### **Neni 13**

Komuna dhe MASHT-i – Inspektorati i Arsimit, do të mbikëqyrin punën e institucionit arsimor lidhur me sigurimin e burimeve, qeverisjen dhe shpenzimin e mjeteve vetanake.

## **III Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

### **Hyrja në fuqi**

#### **Neni 14**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja 01 nr. 110 - 2131, e dt. 20.9.2011, për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore 01. nr. 110 - 15298, të dt. 26.4.2012, si dhe Vendimi për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore 01. nr. 110 - 105888, dt. 02.07.2013.

#### **Neni 15**

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 110 - 157460, më 01.07.2014**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi jur. i dipl.**

## **A r s y e t i m**

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për të hyrat e pushtetit lokal dhe Ligjit për arsimin në komunat e Kosovës – pjesën për të hyrat nga institucionet arsimore, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30.06.2011, ka miratuar Rregulloren për të hyrat vetanak të institucioneve arsimore.

Me qëllim të zbatimit të Udhëzimit administrativ nr. 11/2011, të dt. 30.12.2011, për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimit për të rritur, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 26.4.2011, ka miratuar Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.

Me qëllim të zbatimit të Udhëzimit administrativ nr. 03/2013, për lëshimin e dokumenteve duplikatë nga institucionet edukative – arsimore dhe universitare, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 28.6.2013, ka miratuar Vendimin për ndryshimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.

Duke parë arsyeshmërinë e ndryshimit edhe të disa dispozitave të tjera në rregulloren bazë dhe sugjerimet të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për largim të nenit 7.2, Kuvendit të Komunës i dërgohet për miratim ky propozim.